

VENDIM
Nr. 478, datë 16.7.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I
VARREZAVE PUBLIKE, NË KOMUNËN E VELABISHTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zgjerimi i varrezave publike, në komunën e Velabishtit.

2. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet, të kompensohet sipas masës së dhënë në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 850 (tetëqind e pesëdhjetë) m² tokë bujqësore, me vlerë 172 550 (njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë, si dhe për një sasi pemësh drufrutore me vlerë 135 000 (njëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë.

3. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 307 550 (treqind e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e komunës Velabisht, planifikuar në buxhetin e saj.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna Velabisht.

5. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Regjistrimi i ri i pasurisë, për sipërfaqen 850 (tetëqind e pesëdhjetë) m² tokë bujqësore, të bëhet në favor të komunës së Velabishtit.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna e Velabishtit.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe komuna e Velabishtit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

